



**KONTRATE SHIT-BLERJE**  
**Kuotash te shoqerise "MARKETING GROUP" SHPK me NUIS L81513023B**

TIRANE ME 28 / 10 / 2021

**SHITESI:**

1. Z. Dorian Perndreca, lindur ne Lezhe, Shqiperi, me date 28.06.1984, shtetas Shqipetar, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjofimit me nr. 036624632. Z. Dorian Perndreca, disponon 60 (gjashtedhete) % te kapitalit te shoqerise MARKETING GROUP SHPK, dhe
2. Zj. Daniela Muça, lindur ne Tirane, Shqiperi, me date 11.08.1978, shtetase Shqipetar, banuese ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjofimit me nr. 034481060. Zj. Daniela Muça, disponon 40 (dyzete) % te kapitalit te shoqerise MARKETING GROUP SHPK.

**BLERESI:**

Z. Redjon Stasa, lindur ne Ndernenas, Shqiperi, me date 19.02.1990, shtetas Shqipetar, , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjofimit me nr. 034343298.

- Baza Ligjore :**
1. **Nenet 6, 705 – 750 te Kodit Civil,**
  2. **Neni 73/1 germa "b" e Ligjit 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar,**
    1. **Vendimet e Organeve vendimarrrese te shoqerive tregtare respektive :**
      - **MARKETING GROUP SHPK me NUIS L81513023B,**

Palet me vullnetin e tyre te lire, te plote dhe ne mirekuptim te ndersjellte, redaktuan dhe nenshkruan kete kontrate, ne kushtet dhe me te dhenat e meposhtme:

**TE DHENA PARAPRAKE:**

- I. Shitesi, ka ne pronesi pasurine e luajtshme, 100 (njqind) % te kapitalit te shoqerise MARKETING GROUP SHPK me NUIS L81513023B dhe konkretisht :
- 1) Z. Dorian Perndreca, disponon 60 (gjashtedhete) % te kapitalit te shoqerise MARKETING GROUP SHPK me NUIS L81513023B dhe
  - 2) Zj. Daniela Muça, disponon 40 (dyzete) % te kapitalit te shoqerise MARKETING GROUP SHPK me NUIS L81513023B.

**NENI 1**

**Objekti**

Objekti i kesaj kontrate eshte shitja e pasurise se luajtshme, 100 (njqind) % te kapitalit te shoqerise MARKETING GROUP SHPK me NUIS L81513023B, kontribut ky, qe i perket ortakeve te shoqerise MARKETING GROUP SHPK me NUIS L81513023B, nga shitesi ne favor te bleresit ( Z. Redjon Stasa) dhe konkretisht :

- 1) Z. Dorian Perndreca, i shet bleresit, 60 (gjashtedhete) % te kapitalit te shoqerise MARKETING GROUP SHPK me NUIS L81513023B, ne vleren prej 80,000 (tetedhete mije) Lek;
- 2) Zj. Daniela Muça, i shet bleresit, 40 (dyzete) % te kapitalit te shoqerise MARKETING GROUP SHPK me NUIS L81513023B, ne vleren prej 60,000 (gjashtedhete mije) Lek;

Z. Redjon Stasa, blen 100 (njqind) % te kapitalit te shoqerise MARKETING GROUP SHPK me NUIS L81513023B, ne vleren totale prej 140,000 (njqind e dyzete mije) Lek, te cilat jane ne pronesi te shitesit, ortakeve te shoqerise MARKETING GROUP SHPK me NUIS L81513023B (Z. Dorian Perndreca dhe Zj. Daniela Muça).

## NENI 2

### Çmimi

- 2.1. Shitesi ia shet kete pasuri bleresit kundrejt nje çmimi total bruto prej 140,000 (njqind e dyzete mije) Lek, i ndare sipas raportit te meposhte shenuar:
  - Z. Dorian Perndreca, i shet bleresit, 60 (gjashtedhjet) % te kapitalit te shoqerise MARKETING GROUP SHPK me NUIS L81513023B, ne vleren prej 80,000 (tetedhjet mije) Lek;
  - Zj. Daniela Muça, i shet bleresit, 40 (dyzete) % te kapitalit te shoqerise MARKETING GROUP SHPK me NUIS L81513023B, ne vleren neto prej 60,000 (gjashtedhjet) Lek.
- 2.2. Bleresi do te realizoje pagesen totale te cmimit, objekt te kesaj kontrate, ne vleren prej 140,000 (njqind e dyzete mije) Lek, kundrejt Shitesit ne llogarine bankare te Bleresit.
- 2.3. Kjo pagese do te realizohet pasi Qendra Kombetare e Biznesit te kete aprovuar ndryshimin e 100 % te kapitalit te shoqerise MARKETING GROUP SHPK, ku Blersi te figuroje si Ortak i Vetem me 100 % te kapitalit te shoqerise MARKETING GROUP SHPK.

## NENI 3

### Te drejta dhe detyrime te paleve

- 3.1. Shitesi garanton bleresin per titullin e pronesise te pasurise objekt kontrate dhe per sakesine e dokumentacionit zyrtar te saj, ne te kundert mban pergjegjesi civile per demin e shkaktuar;
- 3.2. Shitesi eshte i detyruar t'i dorezoje pasurine objekt kontrate me te gjitha dokumentacionin perkates bleresit, me marrjen e pageses nga ana e ketij te fundit;
- 3.3. Shitesi eshte i detyruar t'i dorezoje pasurine objekt kontrate bleresit te shkarkuar nga çdo e drejte apo pretendim i te treteve;
- 3.4. Bleresi ka detyrim te njoftojne brenda pese diteve shitesin ne rast se te tretet, ngrene pretendime pronesie mbi sendin objekt kontrate.

## NENI 4

### Kalimi i pronesise

Me nenshkrimin e kontrates, shitesi zhvishet plotesisht nga pronesia mbi pasurine objekt kontrate dhe ajo i kalon e plote bleresit. Bleresi behet zoterues i 100 (njqind) % te kapitalit themeltar te shoqerise MARKETING GROUP SHPK me NUIS L81513023B. Kapitali i shoqerise MARKETING GROUP SHPK me NUIS L81513023B, do te perbehet si me poshteshenuar :


Z. Redjon Stasa, vlere kapitali 100,000 (njqind mije) Lek, 1 (nje) kuote dhe perqindje ne kapital 100 (njqind) %.

## NENI 5

### Te ndryshme

- 5.1. Palet duhet qe te depozitojne kete kontrate ne Qendren Kombetare te Biznesit;
- 5.2. Palet do te perpiqen te zgjidhin me mirekuptim te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin per shkak te ekzekutimit te kesaj kontrate. Ne rast se mosmarreveshjet nuk zgjidhen me mirekuptim kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

### SHITESI

  
.....  
Dorian Perndreca



.....  
Daniela Muça



### BLERESI

  
.....  
Redjon Stasa

